




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 17

Datë 23-03 2023

KONTRATË PROKURIMI NR 13

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Edon Mazreku e lindur me datë 17.11.1993 në Malishevë me numer personal **1234364924**, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

SHERBIME KONSULENTE - NJËMBËDHJETË (11) LOTO LOTO 6 - KONSULENT E NË DREJTORIN PËR ADMINISTRATË me numër identifikues: **62500-23-003-2-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

SHERBIME KONSULENTE NË DREJTORIN PËR ADMINISTRATË

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve është: **8,784.00€ (tetë mijë e shtatë qind e tetëdhjetë e katër euro)** Euro për njëzet e katër (24) muaj.

Pagesa ofruesit të shërbimeve do të bëhet nga data 1-5 në fillim të çdo muaji nga 366.00€ (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro) dhe nga kjo shumë ofruesi i shërbimeve duhet të kryej obligimet tatimore në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(ee) Marrëveshja e kontratës;

(ff) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(gg) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(hh) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(ii) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

(jj) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Edon Mazreku
Pozita:	Menagjer i Prokurimit	Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.03/23	Data:	27.03.2023
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.1	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	2	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 27.03.2023
	2.1	Data e Përfundimit të Shërbimeve është 27.03.2025.
Vendi i Shërbimeve	3	Vendi i kryerjes së shërbimeve është në Komunën e Malishevës - në Drejtorin për Administratë.
Menaxhimi i Kontratës	4	Menaxheri i ofruesit të shërbimeve është zyrtari i drejtorisë për Administratë z.Agim Morina i caktuar me vendim nga ZKA i AK. Menaxheri i ofruesit të shërbimeve është përgjegjës për mbikqyrjen e ofruesit të shërbimeve për tërë periudhën sa zgjatë kontrata duke filluar nga dita e parë e fillimit të shërbimeve deri në përfundimin e kontratës. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë kryerjen e shërbimeve të ofruesit të shërbimeve.
<u>Detyrat kryesore të Konsulentit :</u>	5	Detyrat kryesore: Jurist Konsulent për Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme. Përgaditë hapësirat për aktivitete të ndryshme Ndihmon në zbatimin e vendimeve dhe rregulloreve të drejtorisë Ndihmon në përmbushjen e detyrave të përgjithshme të drejtorisë Ndihmon në organizimin e ambientit të punës, bënë përgaditjen e lëndëve dhe klasifikimin e tyre. Përgatitë raporte dhe evidenca për drejtorinë lidhur me kryerjen e punëve brenda përgjegjësisë në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme. Kryen edhe detyra tjera siç përcaktohen nga drejtori për Administratë të Përgjithshme.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Pagesa do të bëhet në Euro. Obligohet AK që mbasi ta e pranon raportin e kryerjes së shërbimeve nga zyrtari përkatës i caktuar nga ZKA i AK të ia paguaj shumën

		ofruesit të shërbimeve në llogarin bankare të ofruesit të shërbimeve sipas nenit 2 dhe 2.1 të kësaj kontrate.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: EUR.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> b) Përgjegjësia e Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <i>[shëno shumën]</i> d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumën]</i> e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <i>[shëno shumën]</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesa ofruesit të shërbimeve do të i bëhet nga data 1-5 në fillim të çdo muaji nga 366.00€ (treqindëgjashëdhjetëgjashëeuro) dhe nga kjo shumë ofruesi i shërbimeve duhet të kryej obligimet tatimore në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>[shëno]</i> Periudha Garantuese e Defekteve është <i>[shëno datën]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë, ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë të Përgjithëshme
Datë 20.01.2023

SPECIFIKACION

Nr.	Titulli i pozitës së punës	Sasia	Muaj	Paga	Totali
1.	Konsulent për nevoja të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.	1	24	366	8784
TOTALI :					8784

Edon Mazreku